



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ .2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për Ju dhe median në të cilën ushtroni profesionin, në përgjigje të kërkesës tuaj për koment, ardhur nëpërmjet postës elektronike, regjistruar me numër rendor 3, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 1388 Prot., datë 17.02.2023, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, për shkak të situatës së krijuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka filluar procedurën e lëvizjes paralele dhe ka shpallur 10 (dhjetë) pozicione të lira në këtë gjykatë.

Përpara fillimit të zbatimit të kësaj procedure, Këshilli, në respektim të detyrimeve ligjore, nenit 42 e vijues të ligjit për Statusin, ka pozicionuar fillimisht gjyqtarët të cilët në atë moment rezultojnë jashtë strukturave organizative të gjykatave ku ishin emëruar më herët, duke bërë në këtë mënyrë transferim të detyruar të këtyre gjyqtarëve. Ky transferim është bërë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak dhe të situatës dhe nevojës së kësaj gjykate (në këtë gjykatë aktualisht e ushtrojnë detyrën efektivisht 36 gjyqtarë, ndërkohë që struktura organizative e kësaj gjykate është 76 gjyqtarë).

Transferimi i detyruar i gjyqtarëve është realizuar nga Këshilli edhe kur u riorganizuan gjykatat e apeleve, gjyqtarët e të cileve u transferuan në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm si edhe në rastin e suprimimit të ish Gjykatës së Krimeve të Rënda, gjyqtarët e së cilës, të cilët nuk kishin dhënë pëlqimin, iu nënshtruan procedurave të transferimit të detyruar, sipas ligjit.

Pra në çdo rast, kur kemi riorganizim të gjykatave apo suprimim të pozicionit në strukturën organizative të gjykatave, Këshilli do të duhet të vijojë me transferimin e këtyre gjyqtarëve, në një gjykatë tjetër, të të njëjtit nivel.

Në rastin konkret, nuk kemi shkelje të nenit 4 të Ligjit për Qeverisjen dhe ky transferim nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, për sa kohë, ky transferim, është diktuar nga situata e strukturave organizative të gjykatave dhe detyrimit të zbatimit të kërkesave ligjore, përpara fillimit të procedurave të lëvizjes paralele.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!